



PROCESVERBALI

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Rahovec, e mbajtur më **26.04.2019** me fillim në ora **14.10**. Mbledhjen e kryesoi Kryetari Komunës **Smajl Latifi**: Kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi.

Kryetari- Më lejoni ti përshëndes të gjithë të gjithë anëtarët e KKSB, Nënkryetarin e komunës, Fatmir Iska, Drejtorët e Drejtorive, zëvendëskomandantin e stacionit të policisë në Rahovec z. Bekim Vuçitërna, Përfaqësuesit e organizatave, institucioneve që e përcjellin këtë takim të rregullt të KKSB-së, FSK, KFORI, UNMIKU, OSBE, përfaqësuesit e klerit fetar, shefin e ZKK-së z. Lendrit Qeli, përfaqësuesit e mediave dhe gjithë të pranishmit e tjerë që janë prezent në sallë. Ky është takimi i tretë për vitin 2019 i KKSB-së. Propozoj këtë rend dite:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit,
 - Shqyrtimi i dukurive negative, me theks të veçanti trajtimi i objekteve jo të sigurta në Komunën e Rahovecit,
 - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla,
 - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit,
 - Parapërgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve për parandalimin nga zjarri gjatë sezonit veror,
3. Të Ndryshme.

Kryetari - E qes në votim rendin e ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Ka dikush të shtoj diçka sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nëse jo e qes në votim: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar procesverbali nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit.

Kryetari – Vlerësimi ynë për gjendjen e përgjithshme në Komunën e Rahovecit është shumë pozitiv, e qetë, stabile dhe e qëndrueshme, pavarësisht se gjatë kësaj periudhe ka mundur të ketë edhe sfida, por aspak këto nuk e cenojnë situatën e përgjithshme të komunës së Rahovecit. Të gjitha këto situata ose zhvillime të cilat e kanë karakterizuar komunën tonë ndërmjet dy takimeve të KKSB-së, ne i kemi edhe raportet zyrtare çdo 24 orë nga stacioni i policisë në Rahovec. Nga këto raporte ë na kanë ardhur nuk kemi vërejtur diçka serioze që e cenon gjendjen e sigurisë së përgjithshme në komunën e Rahovecit. Por për më shumë informata dhe detaje fjalën ja kalojë togerit z. Bekim Vuçitërna.

Bekim Vuçitërna – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, fillimisht para se të ja filloj të ju raportoj rreth situatës së sigurisë në komunën e Rahovecit, më lejoni që në fillim të ju njoftoj me disa ndryshime që ka pasur stacioni policor në Rahovec në strukturën organizative. Ne pozitën e Komandant Stacioni, kemi Kapiten Fazli Morina, po ashtu është shuar pozita e zëvendës komandant Stacioni, ku unë deri me tani kam ushtruar këtë pozitë, andaj ndryshimi është se tani jam në pozitën e shefit të sektorit operacional stacionit policor në Rahovec.

Sot para jush do të raportoj unë për situatën e sigurisë në komunën e Rahovecit, pasi që komandanti do te mungoj në këtë mbledhje arsyetimi është se i kanë dalë angazhime shtese ne DPP-se Prishtinë.

Vlerësimi i situatës së sigurisë – Sot para jush do të disa statistika për periudhën e tre mujorit të par Janar-Mars te viti 2018/2019. Situata e sigurisë ne komunën e Rahovecit vlerësohet te jete e qete dhe stabile pa ndryshime te rëndësishme te krahasuar për periudhën e tre mujorit te parë Janar - Marsi te vitit 2018/2019. Gjate vitit 2019, janë hapur 133 raste ne total, gjashtë (6) prej tyre janë transferuar ne kompetencë te DRP-se Gjakove, ku prej tyre 5 raste janë penale dhe një incident. Do ju paraqesim disa krahasime ndër vite: Si raste në total kemi pasur në vitin 2018 kanë qenë 103 raste, kurse në vitin 2019 janë 133, pra kemi një ngritje në 29 raste, pastaj vepra penale në vitin 2018 kanë qenë 78, kurse 2019 janë 89, kemi një ngritje prej 11 raste, incidente në vitin 2018 kanë qenë 23, kursen në 2019 janë 39 edhe këtu kemi një rritje prej 12 rasteve, aksidente në trafik në vitin 2018 kanë qenë 14 raste, kurse në vitin 2019 janë 26 raste, kemi një ngritje prej 12 rasteve, tiketa për kundërvajtje në vitin 2018 kanë qenë 1022, kurse në vitin 2019 janë 1450, një ngritje prej 428. Po ashtu do ju paraqesim edhe disa nga veprat penale më serioze: Vrasje nuk kemi pasur, lëndim i rëndë trupor në vitin 2018 2 raste, kurse në vitin 2019 kemi 1 rast, lëndime të lehta trupore në vitin 2018 15 raste, në vitin 2019 kemi 1 rast, pra kemi rrënje, vjedhje në vitin 2018 kemi pasur 23 raste, në vitin 2019 kemi 17, edhe këtu kemi rrënje për 6 raste, grabitje nuk kemi pasur asnjë gjatë kësaj periudhe. Pastaj rastet me ankues minoritar, gjithsej i kemi 6 raste, kurse raste me motive ndëretnike i kemi pasur dy raste, rasti i parë është: Asgjësimi a po dëmtimi i pasurisë (Pllakës përkujtimore, ku me datën 02.02.2019 në afërsi të rrugës rajonale Rahovec -Suhareke saktësisht ndërmjet fshatrave Hoqa e Madhe dhe Zoqishte, është asgjësuar një pllakë përkujtimore e dy gazetarëve serb të shpallur si te zhdukur gjate luftës 1998. Gjatë hetimeve intensive rasti është zbardhur shume shpejt, me pas i dyshuari është arrestuar dhe ka pranuar veprën e kryer dhe rasti është dërguar në prekuri të shtetit, ndërsa pllaka përkujtimore i është kthyer pronarit - shoqatës së gazetarëve Serb. Kurse rasti i dytë është: Asgjësim apo dëmtim i Pasurisë (dëmtimi i kryqit të përmendores dhe dëmtimi i shtizës dhe flamurit të shtetit Serb. Me datën 07.03.2019 është raportuar rasti se në Hoqën e Madhe është dëmtuar një pjesë e përmendores - kryqi mbi përmendoren dhe shtiza së bashku me flamurin Serb. Në bashkëpunim me sektorin e hetimeve rajonale dhe hetimeve në kuadër te stacionit është formuar grupi hetues për zbardhje e rastit ne fjale, rasti është ende në hetime e sipër, por deri më tani nuk kemi diçka të re për të raportuar. Sa i përket incidenteve nëpër shkolla në periudhën kohore janar – mars 2019 janë regjistruar 3 raste, një rast në rrahje në shkollën e mesme Ukshin Hoti Krushe e Madhe. Rasti ka ndodhur si pasojë se dy nxënës të mesme nga shkolla “Xhelal Hajda” janë transferuar e mesme Ukshin Hoti, si masë disiplinore që është mare ndaj tyre, të nderuar shumë shpesh na ndodhin këso raste, nuk e di qëllimi i transferove ose masave që shqiptohen nga drejtoritë e shkollave, a është që të disiplinohen apo të na sjellin më shumë probleme, po ashtu nuk janë të rregullt në vijim të mësimave. Po ashtu edhe në shkollën fillore “Bekim Sylka” kemi pasur një lëndim të lehtë trupor. Pastaj e kemi edhe një rast i cili është shumë i ndjeshëm, ku me datë 10.04.2019, një nxënëse femër 12 vjeçare duke shkuar në shkollë ishte duke ecur rrugës për në shkollë në ora 07:15, pran saj ndalet një i dyshuar i panjohur me automjetin ngjyre të kaltër të mbylltë ku e hap dritaren e automjetit dhe fillon të bej disa pyetje dhe e joshë, më pas viktimë hynë ne automjet dhe i dyshimti gjatë bisedës fillon të shpreh ndjenjat e tij duke e vendosur dorën e viktimës ne organin gjenital të tij. Viktimë pasi ishte shume e shqetësuar është dërguar në QKMF-Rahovec për tretman ku me pas është liruar për ne shtëpi. Rasti i kompletuar mbetet nën hetime kompetencë te njësit Rajonal DRP Gjakovë, ku i dyshuari është kapur dhe arrestuar para tre dite dhe të njëjtit i është caktuar masa e paraburgimit. Desha të kërkoj nga prindërit që të jenë më të kujdesshëm, sidomos tek gjinia femërore, të i paralajmërojnë vajzat e tyre që mos të hipin në vetura të panjohura, edhe pse në këtë rast ky është paraqitur sikurse shok i babait. Pastaj raste tjera të ndjeshme siç janë dhuna ne familje të raportuar për periudhën raportuese tre mujore (janar-mars 2019), janë raportuar 9 raste, këto janë: 3 raste sulm fizik, 2 raste kanosje, 2 raste lëndim të lehtë trupor, 1 rast vetë gjegjësi dhe 1 kërkesë të viktimës, ku nëpërmjet mbrojtësit të viktimave është parashtruar kërkesa për masën mbrojtëse apo Urdhër Mbrojtës, gjithsej nga të gjitha këto raste të përfshirë janë 9 femra dhe 2 meshkuj. Arrestime të personave të

përfshirë në këto raste ,kane qenë nëntë (9) persona, nga këto raste 8 kanë qenë me ndalim 48 orësh, ndërsa njëri rast ju është vazhduar paraburgimi për 15 ditë. Sa i përket viktimave në përgjithësi viktimat janë gjinia femërore edhe gjinia mashkullore, ku prindi shkakton dhunë ndaj djalit të vetë. Kurse sa i përket aktiviteteve policore janar - mars 2019, në asistime dhe angazhime të ndryshme duke ofruar ndihmë institucioneve lokale dhe qendrore ju paraqesim si në vijim: në periudhën 3 mujore i kemi pasur 56 asistime: 8 asistime, inspektoreve miniera dhe minerale, inspektorët e mjedisit dhe planifikimit hapësinor, ku janë inspektuar 17 seperacione buzë shtratit të lumit Drini i Bardh, dhe vetëm 1-ri prej tyre ka poseduar dokumente valide për veprimtarin e ushtruar, ndërsa 16 prej tyre nga inspektorët u janë vendosur shiriti bllokues dhe ndalim i punës derisa të plotësohen kushte ligjore për zhvillimin e veprimtarisë. Ndërsa kompania ndërkombëtare (italiane) FOX MARBLE, e cila përpunon gurë mermeri dhe e njëjta kompani në aspektin e dokumentacionit ishte në rregull, përveç se gjatë gërmimit kishte dalë jashtë pikave gjeodezike të përcaktuara për shfrytëzimin e sipërfaqes që i lejohej të gërmojë. Kësaj inspektorët kanë vendosur shiritin bllokues dhe e kanë ndaluar të zhvillojë veprimtarin deri në plotësimin e kushtit të paraparë me leje të punës. Po ashtu janë inspektuar dy gurëthyes në bjeshkën e Zatriqit dhe të dytë kanë qenë me dokumente të rregullta. Në kuadër të kësaj janë inspektuar edhe 14 fabrika e përpunimit të betonit (betonjerka), nga ata vetëm dy prej tyre posedojnë dokumente të rregullta, ndërsa 12 tjerë i është vendosur shiriti bllokues për zhvillim të veprimtarisë derisa pajisen me leje përkatëse për zhvillimin e veprimtarisë. Gjithashtu në kemi asistuar në mbylljen e (7) Kazinove (lojëra të fatit) në Komunën e Rahovecit, ku në aksion kanë marrë pjesë , Policia për krime të rënda, ATK, dhe një ekip i Doganës së Kosovës, ndërsa pritet në të ardhmen të hyn në fuqi ligji që i ndalon çdo veprimtari tjetër që ka lidhje me lojërat e fatit siç janë bastarët sportive. Po ashtu kemi bërë edhe 10 asistime për përmbarues privat dhe 29 asistime në aktivitete sportive si në futboll dhe basketboll.

Kryetari – I nderuar toger të urrejtë detyrën e re në policinë e Kosovës, siç po shihet detyra e re na ka mundësuar që të kemi një raportim shumë më me shumë detaje, është një kontribut i madh që ju si polici e Kosovës jeni duke bërë në drejtim të rritjes së qëndrueshmërisë së sigurisë së përgjithshme. E dëgjua raportin shefit të operativës togerit z. Bekim Vuçitërna, debati është i hapur nëse ka dikush të shtoj ose të bëjë ndonjë pyetje fjala është e juaja.

Nysret Abazibra – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, ajo që më intereson mua është kualifikimi i veprës vetëgjyqësi, nëse ka mundësi të na shpjegojë shefi i operativës tani z. Bekim Vuçitërna.

Bekim Vuçitërna – Vetëgjyqësi është vepër penale, p

sh kur dikush e merë vetëgjyqësinë në dorë, nuk i pret ta kryejnë punën organet e drejtësisë si policia, prokuroria ose gjykatat, por vetë e zgjidh problemën duke i anashkaluar këta që i përmenda më parë, me kodin penalë kjo vepër është e dënueshme me burgim.

Kryetari – Do i ndajë disa informata me ju si anëtarë të KKS-së, që sipas meje janë të rëndësishme, 11 inspektorët e komunës së Rahovecit kanë marrë detyra shtesë, po ashtu do të paguhet më shumë se që janë paguar deri më tani. Kjo ka ndodhur për ta fuqizuar rolin e të gjitha detyrave që i kanë të përshkruara në kontratë, dhe për të parandaluar ose marrë veprime të përcaktuara në funksion të veprimit të ligjit në komunën tonë. Ne i inkurajojmë inspektorët dhe policinë që të asistojnë në shumë veprime të cilat para vete i kanë, ne po ashtu i përsëritim aksionet fundit që kanë ndodhur në komunën tonë, si mbyllja e të gjitha lojërave e fatit , këto kanë qenë aksione vetëm për ta hetuar se a i kanë të gjithë dokumentacionet në rregull. Por siç e dini tani ligji është gati dhe shpresojmë që shumë shpejtë pas përfundimit të procedurave ligjore shumë shpejtë do të hyjë në fuqi, dhe pastaj për 10 vite do të ndalohet veprimtaria e kazinove dhe të gjitha lojërat e fatit, mendoj se kjo është shumë e dobishme për qytetarët e republikës së Kosovës. Ne do të inkurajojmë dhe do të mbështesim çdo veprimtari, çdo masë dhe çdo plan i cili hynë në funksion të zgjidhjes të disa problemeve, të cilat e cenojnë në një mënyrë ose tjetër interesin e qytetarëve të komunës së Rahovecit. Po ashtu e përsëritim aksionet të cilat i ka ndërmarrë inspektorati i komunës, komisioni i pavarur për miniera dhe minerale, inspektorët e mjedisit së bashku me policinë e Kosovës, i gjithë ky aksion ka qenë për ta parë gjendjen

faktike dhe formale juridike të seperacionve, gurthyesve etj. Po ashtu po ju njoftoj se inspektorati i komunës është duke vazhduar gjithmonë sipas rasteve dhe kërkesave, që të merë masa parandaluese edhe ndëshkuese përmes gjobave mandatore për mbrojtjen e mjedisit. Po ashtu jemi duke u munduar që të bëjmë sa ma shpejtë shenjëzimin e rrugëve dhe rrugicave të komunës sonë, vendosjen e shenjave të nevojshme të komunikacionit, pastaj mirëmbajtjen e ndriçimit publik, jemi të interesuar që të bëjmë diçka rreth funksionimit sa më të mirë të kamerave të sigurisë në qytet. Është lajmi i mirë që fermerët e komunës së Rahovecit do të përfitojnë nga fondi 1 milionësh për kompensim të dëmeve, ku sot ka vendosë të i ndajë Qeveria e Republikës së Kosovës, së paku në këto punë pranverore që i kanë fermerët tanë do të kenë një mundësi që të ecim pak më mirë. Ne do të punojmë që të ketë edhe pagesa të tjera në vazhdim gjatë këtij viti, në mënyrë që të kemi mundësi të i ndihmojmë fermerët tanë. E pamë sa diku ka rritje të krimit, diku ka ulje, por besoj se edhe KKSB-ja është një mekanizëm i fuqishëm i cili mundet të ndikojë në uljen ose parandalimin e veprimeve të elementeve të papërgjegjshme, qoftë nga ata që shkaktojnë dhunë në familje, qoftë atyre që bëjnë tejkalim të rregullave në trafik, qoftë atyre që e cenojnë sigurinë në shkollë. sa i përket transferove të nxënësve nga një shkollë në shkollën tjetër, me udhëzimin administrativ nëse një nxënës i bënë më shumë se 35 mungesa transferohet në një shkollë tjetër. Po ashtu do të shikojmë në bashkëpunim me policinë dhe inspektoratin e komunës që objektet të cilat janë afër shkollave, teqeve, xhamive të cilat munden me qenë burim i të këqijave, të shikohen se a janë të gjitha në rregull me letra dhe tatime. Ka disa vende si në qytet ashtu edhe në disa fshatra që janë për tu inspektuar, gjithmonë flas në informatat që i kam nga policia dhe qytetarët e ndryshëm. Ne e kemi edhe një situatë e cila nuk është potencuar, gjatë këtij 3 mujori ka pasur edhe zjarre, ndoshta edhe të qëllimshme nga faktori njeri, shpresoj se polici do i zbardhë këto raste, sikurse ai që nuk e besoj se është me motive ndëretnike, sepse shumë herë janë duke inskenuar situata për ta prishur imazhin e një komune e cila është stabile, një komunë me njerëz punëtor e cila ka progres në shumë drejtime, prandaj inkurajojë policinë që të zbardhë edhe ato raste që janë ende në hetime. Me kaq unë e mbarojë diskutimin sa i përket pikës së dytë, fjalën e ka Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim z. Hasan Përboqi.

Hasan Përboqi – Përsëritje për të gjithë të pranishmit, do ju raportoj për numrin e përgjithshëm të zjarreve për 3 mujin e parë të vitit 2019. Ne si komunë në 10 vjeçarin e fundit nuk kemi pasur aq shumë zjarre sikurse në këto 3 muaj të parë të vitit 2019, në këtë periudhë janë paraqitur rreth 94 zjarre. Në komplet vitin e kaluar 2018 kemi pasur rreth 130 zjarre, kurse këtë vit ky numër po arin gati vetëm në 3 mujin e parë të vitit. Ne si njësi e zjarrfikësve i kemi bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për sezonin verorë, jemi furnizuar me të gjitha veglat dhe pajisjet e nevojshme për shuarje të zjarrit, po ashtu jemi në pritje që njësia jonë e zjarrfikëse të na pajiset me dy kamionëve të zjarrfikës. Nëse do të përballemi me situatë emergjente ku njësia jonë nuk do të ketë mundësi të i përballoj, ne jemi të gatshëm që të bashkëpunojmë me njësitë e tjera relevante, ku kemi një bashkëpunim të mirë me Drejtorinë e Bujqësisë. Ne do ti angazhojmë gjithashtu edhe rojtarë të pyllit, të cilët janë në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë, po ashtu kemi edhe një fushatë vetëdijësuese për vetëdijesimin e qytetarëve, ku nëpër shkollë fillore, të mesme, në zyrat e vendit, në QKMF, QMF-të, AMF-të, do të shpërndahen fletushka me udhëzime vetëdijësuese, që mos të shkaktojnë qëllimisht zjarret.

Kryetari – Faleminderit drejtor z. Hasan Përboqi, të nderuar ne do të kemi situata të cilat do të lidhen me dëgjime publike, sepse shumë shpejtë do të kemi situatë ku do të bëjmë diçka në qendër të qytetit, mendojmë të bëjmë rregullimin e një sheshi, ku do të bisedojmë me institucionet fetare, me policinë, me qyqarët etj. Pastaj do të kemi situata që lidhen me sheshin qendrorë në qytetin e Rahovecit, jeni duke parë që ka më shumë lëvizje në qytet për arsye të funksionimit të palestrës sportive, pritjet që në këtë palestër të zhvillojnë ndeshje edhe ekipet ndërkombëtare, prandaj ne edhe si komunë por edhe si KKSB do të ngarkohemi me detyra shtesë dhe besoj se do të kemi takime më të shpeshta të cilat gjithmonë them do të dalin sipas nevojës. Ne sa i përket diskutimet e hapura publike me qytetarë pothuajse i kemi kryer, na ka mbetur Hoqa e Madhe dhe lagjet e qytetit. Ju ftoj që të merrni pjesë në këto debate, ne duhet të i tregojmë të gjithëve se ne jemi një komunë normale, pavarësisht çfarë

nacionaliteti kanë qytetarët, edhe pse disa janë duke tentuar që të ja prishin imazhin një komune jashtëzakonisht të mirë dhe të qetë në republikën e Kosovës. Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës.

3. Të ndryshme.

A ka dikush të shtojë diçka ose të na raportoj ndonjë problem që ne nuk e kemi paraparë si pikë të rendit të ditës, fjala është e juaja.

Ramë Berisha – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kur u diskutua rreth zjarreve unë mendova se e kishit fjalën për ata buqja që i ndezin fushate tyre që është mbushur me barishte. Propozimi imë kishte me qenë që së pari të vinë të marrin leje nga komuna, dhe nën mbikëqyrje të komunës të bëjnë ndezjen e zjarreve.

Lulzim Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, e përmendët më parë se keni dhënë urdhër për punë shtesë inspektoratit, po ashtu keni marrë një vendim që të stimuloni me pagë shtesë për punë që do ta kryejnë jashtë orarit të rregullt. Ne disa herë kemi diskutuar rreth fenomenit të ekspozimit të mallrave në trotuare, ajo që është më brengosëse është se janë duke ekspozuar edhe produkte të qumështit. Këto ditë temperaturat kanë filluar të ngritën dhe qytetarët janë të rrezikuar nga malli i kontaminuar, e diskutova këtë temë me qëllim të rritjes së vigjilencës së inspektoratit rreth kësaj çështje. Këto ditë komisioni i cili është formuar nga komuna rreth platformës shëndetësore për 5 vjeçarët e ardhshëm, më parë kam propozuar mundësinë e hapjes së ambientin për vizita specialistike të angazhuar nga spitalet regjionale siç janë Gjakova dhe Prizreni. Kjo të bëhet me qëllim të mos maltretimit të qytetarëve që për një vizitë të thjeshtë të shkojnë në këto spitale regjionale, besoj se me një rregullore të re ka mundësi edhe një diçka e tillë të planifikohet.


Kryetari – Ne së bashku me policin kemi ndërmarrë disa herë veprime për lirim të hapësirave publike, posaçërisht në ato hapësira publike ku ekspozohet malli në kundërshtim me ligjin, ka pasur edhe konfiskim të mallit, këtu janë togeri dhe drejtori i inspektoratit. Është e vërtetë se 3 ose katër shitës janë në qytetin e Rahovecit që bëjnë këso probleme, ata nga njëherë kuptojnë, por nga një herë nuk kuptojnë se uzurpimi i trotuarit është e ndaluar. Këta persona për herë të parë janë detyruar të marrin leje nga komuna, ata e kanë tani hapësirën të cilën ja ka përcaktuar komuna me leje, kjo ka ndodhur për herë të parë, ne jemi duke parë që nga një herë ka tejkalime nga ajo që është dhënë leje, prandaj ne do të jemi të detyruar që ta konfiskojmë mallin. Ne kemi probleme edhe me parkim vend e pa vend të veturave, e kam sugjeruar drejtorin e shërbimeve publike që urgjentisht të shpallet ankand për blerje të një auto merimangë sepse kur ta kemi këtë merimangë do të ndryshojë edhe perceptimi tek vozitësit. Desha të ju njoftoj se e kemi zgjidhur edhe një problem që ka qenë nga viti 1984 në mes familjes Zllanoga dhe Jakupi, tani rruga është duke u bërë, po zbatohet një marrëveshje e cila është bërë në mes komunës dhe palëve që i përmenda më parë. Nëse e mbërrim të i zgjidhim bashkë edhe me ju dhe të gjithë akterët të cilët munden të ndihmojnë sepse kemi disa probleme si me ujërat e zeza, pastaj kemi problem me hapje të rrugës në lagjen Vëllezërit Frashëri, ndonjë herë në shoqëri duhet kontributi i të gjithëve për të zgjidhur disa probleme.

Të nderuar me kaq përfundoj takimi i sodit, ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë, mirupafshim në takimet e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00

Procesmbajtësi

Hamza
Skender Hamza



Kryetari i Komunës

Smajl Latifi
Smajl Latifi